



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr _____ prot

Gramsh, më 16/07/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 16.07.2020

Për: Operatorin Ekonomik - "Victoria Invest" sh.p.k

Adresa: Lagjja 28 Nëntori, rruga 11 Nëntori, pallati pranë Tatim Taksave, kati 2, Elbasan
Procedura e prokurimit: "E hapur", me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-58204-05-15-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksion i rrugës Unaza e qytetit", me afat 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike 26/05/2020 [Nr. 30]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

* * *

1. **Shoqëria - "K-AAV" sh.p.k**, me nr.Nipti L51506025C me vlerë të ofertës 19 862 400 (nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e katërqind)lekë,pa TVSH.
2. **Shoqëria- "Victoria Invest" sh.p.k** me nr.Nipti K32712206U me vlerë të ofertës 20 613 310 (njëzetëmilionë e gjashtëqind e trembëdhjetëmijë e treqind e dhjetë)lekë,pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

1. Shoqëria- "K-AAV" sh.p.k , për arsyet :

Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorëzuar në SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kërkuar në Kriteret e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të përkohshme në DST, si më poshtë:

- Nuk ka dorëzuar dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2019 në kundërshtim me pikën 2.2.3 të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.6 "Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë", pasi shoqëria "K-AAV" sh.p.k, në licensën nr.NZ.7193/2 nuk përmban kategorinë NP-12 -A (Punime të inxhinierisë së mjedisit), kategori e kërkuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.6 "Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë", pasi shoqëria "K-AAV" sh.p.k, në licensën nr.NZ.7193/2 nuk përmban kategorinë NS-9 -A (Punime strukturore speciale), kategori e kërkuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.6 "Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë", pasi shoqëria "K-AAV" sh.p.k, në licensën nr.NZ.7193/2 nuk përmban kategorinë

NS-19 -A(Sisteme kundra zhurmës për infrastrukturën) ,kategori e kërkuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.

- Nuk përmbush kriterin për 80 punonjës për periudhën 6-muaj nga data e zhvillimit të tenderit pasi nga vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore nr.T02485981,datë 23.06.2020 dhe listë pagesave të sigurimeve shoqërore, figurojnë të punësuar 26 punonjës për këtë periudhë, në kundërshtim me pikën 2.3.2 të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.
- Referuar ekstraktit të thjeshte dhe atij historik të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE),administratori dhe ortakut i vetem i operatorit ekonomik është Znj.Xhemile Kora. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se të gjitha shtojcat,dokumentacioni ekonomik teknik dhe ligjor janë të nënshkruara nga Z.Melev Kora .Z.Melev Kora nuk ka tagrin ligjor të përfaqësimit të Operatorit Ekonomik K-AAV pasi nuk rezulton të ketë në sistem prokurë të përgjithshme për të cilën ky person autorizohet të përfaqësojë dhe nënshkruajë dokumentacionin e Operatorit Ekonomik K-AAV.Si rrjedhojë,shtojca 12 Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit,si dhe kriteret e vecanta të kualifikimit konsiderohet e pa plotësuar.
- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2 të DST për kapacitetin ekonomik dhe financiar.
- Mungon dokumentacioni për vërtetimin e punëve të ngjashme pasi punimet e kryera nga ana juaj nuk kanë ngjashmëri me objektin e prokurimit nga Autoriteti ynë Kontraktor objekti i së cilës është i llojit rrugë.Vec kësaj, dokumentacioni i paraqitur nga ana juaj konsiderohet i pavlefshëm pasi kontrata e sipërmarrjes nuk është lidhur mes 2 palëve por vetëm nga një palë e vetme ,edhe në cilësinë e investitorit,po kështu në cilësinë e sipërmarrësit .
- Kontrata e punës së Drejtuesit teknik Fatmir Mukaj nuk është e vlefshme pasi afati i saj ka qenë 5 vjet.Kontrata është lidhur më datë 13.03.2015, dhe ka qenë e vlefshme deri më 13.03.2020.
- Për asnjë nga drejtuesit e makinerive të rënda nuk është dorëzuar kontrata noteriale e punës në kundërshtim me Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk përmbush kriterin për një inxhinier mjedisi në kundërshtim me pikën 2.3.3 të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk ka dorëzuar certifikatën EN -ISO 14001-2015(Sistemi I Menaxhimit të Mjedisit) në kundërshtim me pikën 2.3.9 të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.
- Për fabrikën e asfalto betonit nuk është dorëzuar leje mjedisore me kod III.I.B dhe kontrata e shitjes nuk është noteriale.
- Nuk ka dorëzuar dokumentacion për një impiant për thyerje dhe seleksionim materialesh inertesh.
- Nuk ka dorëzuar Liçensë e lëshuar nga QKB per vleresim i ndikimit ne mjedis **(Kodi III.2.A)**si dhe Liçensë e lëshuar nga QKB per grumbullim dhe transportim i mbetjeve te llojeve te ndryshme **(Kodi III.2.B)** në kundërshtim me pikën 2.3.9 të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk ka dorëzuar për mjekun e shoqërisë kontratë noteriale pune si dhe lejen e ushtrimit të profesionit (urdhër mjeku) në kundërshtim me pikën 2.3.5 të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk përmbush kriterin për mjetin autobetoniere mungon leje qarkullimi,certifikata e pronësisë,certifikata e kontrollit teknik,siguracioni .
- Nuk përmbush kërkesat për mjetet e makineritë e kërkuara në pikën 2.3.7 të Kriteret të vecanta të kualifikimit Mjet transporti veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 12 ton, Kamioncine me vinc, me kapacitet mbajtes deri ne 1.5 ton, Ekskavator me zinxhir me peshe 25 – 30, Eskavator me zinxhire me peshe 45 – 50 ton, Buldozer me peshe 30 – 40 ton, Makineri per bordurat e betoni me zinxhire, Kamion Dumper (per kantier), Ekskavator me zinxhir mbi 60 ton me krahe min18 m per prishjen e ndertimeve, Ngrites teleskopik, etj

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë - Shoqërinë-“Victoria Invest”**

sh.p.k , me adresë Lagjja 28 Nëntori, rruga 11 Nëntori, pallati pranë Tatim Taksave , kati 2,Elbasan, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **20 613 310 (njëzetë milionë e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e dhjetë) lekë, pa TVSH**, pikët totale të marra [____], është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Gramsh**, Bulevardi “10 korriku”, Sheshi “Kamber Dërmyshi “, pranë Njësisë së Prokurimit, kati tretë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [____], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08.07.2020.

Ankesa: Nuk ka pasur ankesa

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**KRYETARI
KLODIAN TAÇE**

Konceptoi: E.Guzi

Miratoi: E.Guzi

Dosja nr: _____

Afati i ruajtjes: _____